



PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi – Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenkovic – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “IDEA EET” sh.p.k –Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Iris Pharma” sh.p.k; Ardi sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore”, me nr. të prokurimit: 613-20-5228-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Lipjan , më datën: 01.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “IDEA EET” sh.p.k –Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore”, me nr. të prokurimit 613-20-5228-1-2-1, iniciuar nga AK- Komuna Lipjan.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore”, me nr. të prokurimi 613-20-5228-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Lipjan.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "IDEA EET" sh.p.k –Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "IDEA EET" sh.p.k –Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesën me nr. 08/21 në OSHP, me datë 05.01.2021, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore", me nr. të prokurimit: 613-20-5228-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Lipjan duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 10 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6.1 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 13.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

**Sqarim hyrës:** Komuna e Lipjanit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim. Ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe se Paneli Shqyrtues lidhur me këtë aktivitet ka nxjerrë vendimet me numër 944/2020.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "IDEA EET" sh.p.k –Suharekë, ka qenë ankues edhe herën e parë ndërsa pas vendimit PSH.nr.944/20, i cili vendim lëndën e kthen në rivlerësim. AK përmes ri-vlerësimit rekomandon për kontratë një grup të operatorëve ekonomik tjerë.

Prendimi ankimor i OE ankues sipas kësaj ankesë ka të bëjë me qasjen në dokumentacionin e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë. Ku në bazë të shkresave të lëndës rezulton se OE ankues me datën 14.12.2020, përmes e-malit dhe përmes platformës elektronike ka dorëzuar kërkesën për qasje në dokumentet e tenderit. AK ka kthyer përgjigje me datën 15.12.2020, në ora 08.13 dhe ka shkruar: "Për

qasje në dokumentacionin, ejani sot në ora 10:00” ndërsa OE ankues as nuk e konfirmon pjesëmarrjen dhe as nuk e konteston afatin e shkurtër për qasje në dokumente sipas kërkesës. Lidhur me mos shkuarjen e OE ankues sipas orarit të përcaktuar nga AK, OE ankues pretendon se AK ka dhënë një afat shumë të shkurtër për qasje në dokumentacionin e tenderit me arsyetimin se ka qenë duke u marrë me çështje të biznesit jashtë zyrës dhe nuk ka mundur të shkoj në kohën e caktuar nga ana AK-së për një afat që të shkurtër të cilën ka caktuar AK. OE ankues në ankesë pretendon se më këtë veprim nga AK është shkelur nenin 39 të RRUOPP-s pika 39.6 pasi që na ka dhënë një afat shumë të shkurtër kohor për tu paraqitur në zyrën e prokurimit para më pak se dy orë. AK nuk na ka dhënë kohë miatueshme sikur është cekur në dispozitat e këtij neni. Më tej, OE ankues sqaron në ankesë se me datë 16.12.2020 është paraqitur më zyrën e prokurimit të AK-së për të shikuar dokumentacionin tenderik por menaxheri i prokurimit ka refuzuar që ti jep qasje me arsyetimin se afati për qasje ka kaluar dhe juve nuk ju lejohet qasja. Pastaj, OE ankues shton se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 të LPP-së paragrafët 4.4 dhe 5 të cilat shprehimisht kanë paraparë të drejtën tonë si palë e interesit për qasje në dokumentacion tenderik ku si palë e interesit kemi të drejtë të qasje të dokumentacionit tenderik sipas dispozitave të nenit 10 dhe autoriteti kontraktues është i obliguar që ti siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje.

#### **Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) “IDEA EET” sh.p.k - Suharekë**

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimit ankimor në lidhje me kërkesën e parashtruar në AK për qasje në dokumentet e tenderit, sqaron se në paragrafin 3, 4 dhe 5 të nenin 10 të LPP-së (Mjetet për promovimin e transparencës) është përcaktuar se autoritetet kontraktuese duhet të lejojnë qasje operatorëve ekonomik. Mirëpo, në nenin 10 të LPP-së nuk ka ndonjë afat të caktuar për qasje në këto dokumente, si dhe nuk është e përcaktuar sa herë ka të drejtë operatori ekonomik të ketë qasje. Po ashtu, në pikën ankimore të OE ankues se si palë e interesit kemi të drejtë të qasjes të dokumentacionit tenderik në mënyrë të rregullt të qetë dhe pa pengesa sa herë që e bëjmë një kërkesë për qasje ekspert shqyrtues sqaron se në par. 4 të nenit 10 të LPP-së thuhet: 4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafi 3 i këtij neni në mënyrë të rregullt të qetë dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave. Pra, në bazë të dispozitës së cekur më lartë ekspert shqyrtues sqaron se AK i ka dhënë qasje dhe i ka caktuar kohën kur mundet OE ankues të ketë qasje, ndërsa OE ankues nuk ka shkuar në kohën e përcaktuar. Ndërsa në lidhje me pikën ankimore se duhet të kemi qasje “sa herë që e bëjmë një kërkesë për qasje”, ekspert shqyrtues sqaron se sipas nenit 10 të LPP-së nuk përcaktohet se operatorët ekonomik mund të bëjnë kërkesë për qasje në mënyrë të vazhdueshme duke nënsëritur kërkesën e njëjtë disa herë. Për më tepër, ekspert shqyrtues sqaron se përderisa AK i ka caktuar kohën se kur OE mund të

ketë qasje në dokumentet e tenderit dhe OE ankues as nuk e ka konfirmuar pjesëmarrjen as nuk e ka komësuar orarin e caktuar nga AK, për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim është i pa bazuar. OE ankues ka mundur që ti përgjigjet e-mailit të AK-së me kërkesë për kohë më të përshtatshme, mirëpo mos përgjigjetja e OE me arsyelimin se ka pasur të merret me çështje të biznesit tashmë zotë, është në vullnetin dhe aspektet menaxheriale të OE ankues për caktimin e prioriteve në menaxhimin e çështjeve të biznesit. Sa i përket pikës ankimore se AK ka shkelur nenin 39 dhe pikën 39.6 të RRUOPP-së për shkak të afatit shumë të shkurtë për qasje në dokumentacionin e tenderit dhe AK nuk na ka dhënë kohë mjaftueshme sikur është cekur në dispozitat e këtij neni, eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se neni 39 i RRUOPP-së nuk ka asnjë lidhje me afatin apo kërkesën për qasje në dokumentet e tenderit. Neni 39 i RRUOPP-së sqaron procedurën apo procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nga ana e autoritetit kontraktues, ku komisioni i vlerësimit nëse i duhet që të marr informacione shtesë për tenderin e ndonjë operatori ekonomik, konform nenit 39 të RRUOPP-së dhe nenit 59.2 të LPP-së mund të kërkoj informata për sqarim të tenderit nga ana e operatorëve ekonomik. Kurse, pika 39.6 të cilën e ka cekur OE ankues në ankesë, flet për përputhjen e operatorëve ekonomik në rastet kur AK kërkon sqarimin e tenderit nga OE, ku në këtë pikë thuhet: AK do të caktoj afat kohorë të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. Lidhur me pikën tjetër ankimore të OE ankues, se gjatë vlerësimit të parë AK ka shpërblyer me kontratë një OE i cili ka ofruar tenderin me çmim më të lartë se oferta të cilën e ka shpallur fitues pas rivlerësimit të tenderit edhe pse është e ditur se në rivlerësim nuk kanë ndryshuar ofertat. Nëse tenderi i një tenderuesi gjatë vlerësimit të parë është cilësuar si tenderues me çmim jo normalisht të ulët atëherë me qenë se nuk ka pasur ndryshim të ofertave pasi është kthyer lënda në rivlerësim nga OSHP është dashur që të iniciohet procedura për tender jo normalistë të ulët edhe pas rivlerësimi. AK nuk e ka cilësuar tenderin e grupit të OE si tender jo normalistë të ulët. Andaj vlerësimi jo i drejtë i tenderit paraqet shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron se në ekspertizën paraprake për pikën ankimore "tender jo normalisht të ulët" është sqaruar nga eksperti se AK me rastin e aplikimit të formulës sipas nenit 3 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët, gabimisht kishte aplikuar këtë rregull sepse i kishte kalkuluar të gjithë tenderët (duke përfshirë edhe operatorët ekonomik të cilët i ka trajtuar si të pa përgjegjshëm). Pra, përderisa edhe Panelit Shqyrtues ka nxjerr vendim për këtë pikë dhe një prej arsveve pse lënda është kthyer në ri-vlerësim ka qenë se AK e ka zbatuar gabimisht rregullat për tenderët jo normalisht të ulët duke i kalkuluar të gjithë tenderët e përgjegjshëm dhe pa përgjegjshëm. Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron se përderisa në vendimin paraprak është vendosur kjo çështje për tenderët jo normalisht të ulët, atëherë nuk mund të merret si pikë reference nga OE ankues edhe në këtë proces të vlerësimit. Po ashtu, me rastin e kthimit në ri vlerësim (një prej pikave që më herët ka qenë lidhur me tenderët jo normalisht të ulët", ky proces i vlerësimit është i pa varur me vlerësimin e mëhershëm.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e OE ankues se AK nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me rastin e parashtrimit të kërkesës për ri-shqyrtim si dhe nuk ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës edhe përkundër se në kërkesën tonë ia kemi kërkuar një gjë të tillë, eksperti shqyrtues sqaron se secili autoritet kontraktues është i obliguar që të pezulloj procedurën me rastin e kërkesës për rishqyrtim konform nenit 6 të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave. Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron se dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar (shih par 2 të nenit 108/A të LPP-së). Megjithatë, duhet të ceket se AK ka ngarkuar një vendim për pezullim të aktivitetit që ka datën 11.12.2020 sipas kërkesës për ri shqyrtim nga OE ankues "IDEA", por kjo datë duhet të jetë gabim sepse sipas rrjedhës kronologjike të procedurës nuk lidhet me asnjë veprim tjetër përveç se me datën e raportit të rivlerësimit. Megjithatë, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përfundimisht, sipas asaj që u përshkrua dhe kundrejt pretendimeve ankimore rezulton që AK – Komuna Lipjan, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit në përgjithësi ka vepruar konform dispozitave të LPP-së, si dhe ka pasur parasysh nenin 1 dhe 6 të LP-së.

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport propozimi ynë është që ankesa e OE ankues të aprovet pjesërisht e bazuar, dhe ti lejohet AK-së, të procedoi tutje me aktivitetin e prokurimit, konform dispozitave të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 13.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 13.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "IDEA EET" sh.p.k – Suharekë, me datë: 14.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

#### Sqarim:

Në lidhje me procedurën e prokurimit me nr. 613-20-5228-1-2-Ititulli: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshpër të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore**, përmes emailit me datën 13.01.2021, kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues me numër të lëndës 08/21

Pas analizimit të raportit vërejtëm që disa nga pretendimet tona ankimore të parashtruara në ankesën tonë të datës 04.01.2021 me nr. 08/21, janë konstatuar si të pa bazuara. Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues në lidhje me të drejtën tonë ligore për qasje në dokumentacionin e tenderit si dhe me vlerësimin e tenderit, pasi që eksperti shqyrtues pretendimet tona i ka vlerësuar njëanshëm. Më poshtë po japim mendimet tona në lidhje me përgjigjen e ekspertit shqyrtues sipas pretendimeve ankimore. Sa i përket qasjes në dokumentacionin tenderik, ne në ankesën tonë kemi cekur se në herën e parë nuk kemi mundur që të paraqitemi për një kohë shumë të shkurtër më pak se 2 orë në objektet e AK-s. Ne jemi paraqitur ditën e nesërme por pa kurrëfarë arsye, nuk na është dhënë qasja në dokumente nga zyra e Prokurimit. Andaj jemi detyruar që ta përsërisim kërkesën dhe pas kërkesës së dytë nuk kemi marrë kurrëfarë përgjigje nga AK. Konkluzioni i ekspertit shqyrtues se pretendimi në lidhje me qasjen në dokumentacion tenderik është i pa bazuar është konkluzion tërësisht i gabuar. Neni 10 i LPP-s e ka rregulluar këtë qështje në paragrafin 3, 4 dhe 5. Në këto dispozita nuk është përcaktuar se pala e interesuar ka të drejtë të kërkojë sa herë të dojë qasje por nuk është cekur as se pala ka të drejtë që vetëm një herë të ketë qasje në dokumentacion. Andaj është e kuptueshme se nëse diqka nuk është e ndaluar atëherë është e lejuar. Dispozita e nenit 3 shprehimisht ka paraparë që me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje, andaj me qenë se neve nuk na është dhënë qasja AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 10 të LPP-s.

Sa i përket kohës apo konkluzionit se O.E. ankues as nuk e ka konfirmuar pjesëmarrjen as nuk e ka kontestuar orarin dhe se ky pretendim është i pa bazuar mendoj se ky konkluzion është i gabuar, pasi që po ta kishim vërejtë ne që kemi pranuar një email gjatë ditës, me siguri që do të kishim kërkuar nga AK këtë zgjasë afatin, mirëpo ne e kemi vërejtur në mbledhje që na është dhënë qasja brenda më pak se dy ore. Andaj të nesërmen jemi paraqitur pranë AK-s por nuk na është dhënë qasja. Sa i përket përgjigjes në lidhje me mos aplikimin e tenderit jon normalisht të ulët, ne jemi të vetëdijshëm se eksperti gjatë ankesës së parë dhe Paneli Shqyrtues e kanë sqaruar se AK ka aplikuar formulën sipas nenit 3 të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, mirëpo edhe pse është kthyer në rivlerësim tenderi dhe është zhvilluar një vlerësim i pa varur me vlerësimin e më hershëm, ofertat kanë qenë të njëjta dhe AK është dashur që të aplikoj përsëri formulën për tenderin jo normalisht të ulët por tani duke aplikuar në mënyrë të duhur sikur është sqaruar në vendimin e panelit shqyrtues. Eksperti ka cekur se procesi i vlerësimit është i pa varur me vlerësimin e më hershëm, mirëpo nuk e ka marrë parasysh se me rastin e rivlerësimit nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi që të trajtoj një tender si tenderi jonormalisht i ulët në rastin kur është paraqitur një tender i tillë. Andaj mos zbatimi i rregullave për tenderet jo normalisht të ulët ndikon edhe te vlerësimi i tenderi i cili është dashur që të bëhet në bazë të nenit 59 të LPP-s. E vetmja pikë që ne pajtohemi me mendimin e ekspertit është në lidhje me pretendimin tonë për shkelje të nenit 6 paragrafi 6.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të

ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, me të cilin ka konstatuar se pretendimi jonë është i bazuar dhe ka konstatuar që AK ka bërë shkelje të këtyre rregullave. Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, i rekomandojmë Panelit Shqyrtues, që të mbaj seancën dhe pas konstatimit të shkeljeve të paraqitura në ankesën tonë, të njëjtën ta aprovon si të bazuar dhe të anulon vendimin e AK-s për dhënie të kontratës dhe lëndën ta kthej në rivlerësim si dhe ta urdhëron Autoritetin Kontraktues që të eliminon shkeljet e cekura më lartë dhe të na të na jep qasje të dokumentacionit tenderik.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.01.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor i OE ankues "IDEA EET" sh.p.k –Suharekë sipas kësaj ankesë ka të bëjë me qasjen në dokumentacionin e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë. Ku në bazë të shkresave të lëndës rezulton se OE ankues me datën 14.12.2020, përmes e-mailit dhe përmes platformës elektronike ka dorëzuar kërkesën për qasje në dokumentet e tenderit. AK ka kthyer përgjigje me datën 15.12.2020, në ora 08.13 dhe ka shkruar: "Për qasje në dokumentacionin, ejani sot në ora 10:00" ndërsa OE ankues as nuk e konfirmon pjesëmarrjen dhe as nuk e konteston afatin e shkurtër për qasje në dokumente sipas kërkesës. Lidhur me mos shkuarjen e OE ankues sipas orarit të përcaktuar nga AK, OE ankues pretendon se AK ka dhënë një afat shumë të shkurtër për qasje në dokumentacionin e tenderit me arsyetimin se ka qenë duke u marrë me çështje të biznesit jashtë zyrës dhe nuk ka mundur të shkoj në kohën e caktuar nga ana AK-së për një afat aq të shkurtër të cilën ka caktuar AK. OE ankues në ankesë pretendon se më këtë veprim nga AK është shkelur nenin 39 të RRUOPP-s pika 39.6 pasi që na ka dhënë një afat shumë të shkurtër kohor për tu paraqitur në zyrën e prokurimit para më pak se dy orë. AK nuk na ka dhënë kohë mjaftueshme sikur është cekur në dispozitat e këtij neni. Më tej, OE ankues sqaron në ankesë se me datë 16.12.2020 është paraqitur më zyrën e prokurimit të AK-së për të shikuar dokumentacionin tenderik por menaxheri i prokurimit ka refuzuar që ti jep qasje me arsyetimin se afati për qasje ka kaluar dhe juve nuk ju lejohet qasja. Pastaj, OE ankues shton se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 të LPP-së paragrafët 3,4 dhe 5 të cilat shprehimisht kanë paraparë të drejtën tonë si palë e interesit për qasje në dokumentacion tenderik, ku si palë e interesit kemi të drejtë të qasje të dokumentacionit tenderik sipas dispozitave të nenit 10 dhe autoriteti kontraktues është i obliguar që ti siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues pas analizimit të pretendimit ankimor në lidhje me kërkesën e parashtruar në AK për qasje në dokumentet e tenderit, sqaron se në paragrafin 3, 4 dhe 5 të nenin 10 të LPP-së (Mjetet për promovimin e Transparencës) është përcaktuar se autoritetet kontraktuese duhet ti lejojnë qasje operatorëve ekonomik. Mirëpo, në nenin 10 të LPP-së nuk ka ndonjë afat të caktuar për qasje në këto dokumente, si dhe nuk është e përcaktuar sa herë ka të drejtë operatori ekonomik të ketë qasje. Po ashtu, në pikën ankimore të OE ankues se si palë e interesit kemi të drejtë të qasjes të dokumentacionit tenderik në mënyrë të rregullt të qetë dhe pa pengesa sa herë që e bëjmë një kërkesë për qasje. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në par. 4 të nenit 10 të LPP-së thuhet: 4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafi 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave. Pra, në bazë të dispozitës së cekur më lartë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK i ka dhënë qasje dhe i ka caktuar kohën kur mundet OE ankues të ketë qasje, ndërsa OE ankues nuk ka shkuar në kohën e përcaktuar. Ndërsa në lidhje me pikën ankimore se duhet të kemi qasje “sa herë që e bëjmë një kërkesë për qasje”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sipas nenit 10 të LPP-së nuk përcaktohet se operatorët ekonomik mund të bëjnë kërkesë për qasje në mënyrë të vazhdueshme duke përsëritur kërkesën e njëjtë disa herë. Përderisa AK i ka caktuar kohën se kur OE mund të ketë qasje në dokumentet e tenderit dhe OE ankues as nuk e ka konfirmuar pjesëmarrjen as nuk e ka kontestuar orarin e caktuar nga AK, rezulton se ky pretendim është i pa bazuar. OE ankues ka mundur që ti përgjigjet e-mailit të AK-së me kërkesë për kohë më të përshtatshme, mirëpo mos përgjigja e OE me arsyetimin se ka pasur të merret me çështje të biznesit jashtë zyrës, është në vullnetin dhe aspektet menaxheriale të OE ankues për caktimin e prioriteteve në menaxhimin e çështjeve të biznesit.

Sa i përket pikës ankimore se AK ka shkelur nenin 39 dhe pikën 39.6 të RRUOPP-së për shkak të afatit shumë të shkurtë për qasje në dokumentacionin e tenderit dhe AK nuk na ka dhënë kohë mjaftueshme sikur është cekur në dispozitat e këtij neni, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues fillimisht sqaron se neni 39 i RRUOPP-së nuk ka asnjë lidhje me afatin apo kërkesën për qasje në dokumentet e tenderit. Neni 39 i RRUOPP-së sqaron procedurën apo procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nga ana e autoritetit kontraktues, ku komisioni i vlerësimit nëse i duhet që të marrë informacione shtesë për tenderin e ndonjë operatori ekonomik, konform nenit 39 të RRUOPP-së dhe nenit 59.2 të LPP-së mund të kërkojë informata për sqarim të tenderit nga ana e operatorëve ekonomik. Kurse, pika 39.6 të cilën e ka cekur OE ankues në ankesë, flet për përgjigjen e operatorëve ekonomik në rastet kur AK kërkon sqarimin e tenderit nga OE, ku në këtë pikë thuhet: AK do të caktoj afat kohorë të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. Lidhur me pikën tjetër ankimore të OE ankues, se gjatë vlerësimit të parë AK ka shpërblyer me kontratë një OE i cili ka ofruar tenderin me çmim më të lartë se oferta të cilën e ka shpallur

fitues pas rivlerësimit të tenderit edhe pse është e ditur se në rivlerësim nuk kanë ndryshuar ofertat. Nëse tenderi i një tenderuesi gjatë vlerësimit të parë është cilësuar si tenderues me çmim jo normalisht të ulët atëherë me qenë se nuk ka pasur ndryshim të ofertave pasi është kthyer lënda në rivlerësim nga OSHP është dashur që të iniciohet procedura për tender jo normalisht të ulët edhe pas rivlerësimit. AK nuk e ka cilësuar tenderin e grupit të OE si tender jo normalistë të ulët. Andaj vlerësimi jo i drejtë i tenderit paraqet shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së. Lidhur me këtë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kjo çështje është trajtuar më herët për pikën ankimore “tender jo normalisht të ulët”, ku është sqaruar se AK me rastin e aplikimit të formulës sipas nenit 3 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët, gabimisht kishte aplikuar këtë rregull sepse i kishte kalkuluar të gjithë tenderët (duke përfshirë edhe operatorët ekonomik të cilët i ka trajtuar si të pa përgjegjshëm). Pra, përderisa edhe Panelit Shqyrtues ka nxjerr vendim për këtë pikë dhe një prej arsyeve pse lënda është kthyer në ri-vlerësim ka qenë se AK e ka zbatuar gabimisht rregullat për tenderët jo normalisht të ulët duke i kalkuluar të gjithë tenderët e përgjegjshëm dhe pa përgjegjshëm. Përderisa në vendimin paraprak është vendosur kjo çështje për tenderët jo normalisht të ulët, atëherë nuk mund të merret si pikë reference nga OE ankues edhe në këtë proces të vlerësimit. Po ashtu, me rastin e kthimit në ri vlerësim (një prej pikave që më herët ka qenë lidhur me tenderët jo normalisht të ulët”, ky proces i vlerësimit është i pa varur me vlerësimin e mëhershëm.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e OE ankues se AK nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me rastin e parashtrimit të kërkesës për ri-shqyrtim si dhe nuk ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës edhe përkundër se në kërkesën tonë ia kemi kërkuar një gjë të tillë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se secili autoritet kontraktues është i obliguar që të pezulloj procedurën me rastin e kërkesës për rishqyrtim konform nenit 6 të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave. Gjithashtu, dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar (shih par 2 të nenit 108/A të LPP-së). Megjithatë, duhet të ceket se AK ka ngarkuar një vendim për pezullim të aktivitetit që ka datën 11.12.2020 sipas kërkesës për ri shqyrtim nga OE ankues “IDEA”, por kjo datë duhet të jetë gabim sepse sipas rrjedhës kronologjike të procedurës nuk lidhet me asnjë veprim tjetër përveç se me datën e raportit të rivlerësimit. Megjithatë, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se sipas asaj që u përshkrua dhe kundrejt pretendimeve ankimore, rezulton që AK – Komuna Lipjan, gjatë

këtij aktiviteti të prokurimit në përgjithësi ka vepruar konform dispozitave të LPP-së, si dhe ka pasur parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Nubi PAÇARIZI

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK Komuna e Lipjanit;

1x1 OE "IDEA EET" sh.p.k –Suharekë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.